



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2023:209874

Datë: 04.11.2024

Numri i dokumentit: 06394785

C.nr.1419/23

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Binak Duqi, dhe bashkëpunëtorin profesional Mensur Avdullahu, në çështjen juridike kontestimore të paditëses D. A. nga P., me numër personal, të cilin e përfaqëson Avokatura “K. dhe A.”, me av. S. K., etj, nga P., Blv. “D. e K.”, Lagja U. C-..., me autorizim, kundër të paditurës Komuna e Podujevës, Drejtoria Komunale e Arsimit nga P., Rruga “N. G.” pn. e përfaqësuar nga përfaqësuesi i Komunës për konteste juridike F. R., me objekt kontesti Kompensimin e shujtave (ushqimit), me vlerë të kontestit: **838.00 Euro**, jashtë seance me dt.02.11.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

-pa shqyrtim kryesor të çështjes -

I. APROVOHET pjesërisht padia dhe kërkesëpadia e paditëses D. A. nga P., **si e bazuar**, dhe

II. DETYROHET e paditura Komuna e Podujevës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses D. A. nga P., që t’ia kompensojë në emër të ushqimit ditor për ditët e pranisë në punë – shujta (për periudhën kohore 01.09.2021 deri më 21.11.2022), për 419 ditë pune shumë prej 838.00 euro. Shumen e aprovuar për paditësen prej 782.00 euro e paditura detyrohet t’ia paguaj me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar ti llogaritet nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 174.00 eurove, të gjitha në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

IV. Refuzohet kërkesa e paditëses që kamata ligjore 8 % ti llogaritet nga dita e ushtrimit të padisë në gjykatë e deri në pagesën definitive, si e pa bazuar.

A r s y e t i m

Paditësja D. A. nga P., përmes te autorizuarit te saj, me datën 04.10.2023 ka paraqitur padi kundër të paditurës për pagesën e shujtave të ushqimit ditor, ashtu që ka kërkuar shumë e përgjithshme prej 838.00 € dhe atë për 419 ditë pune për periudhën nga data 01.09.2021 e deri me dt. 21.11.2022.

Ka shtuar se është në marrëdhënie të rregullt pune te e paditura në vendin e punës si mësimdhënës tek e paditura ne SHFMU “I. R.” në K P., sipas Kontratës se Punës nr. prot. 1143/2 e dates

01.09.2021. Ka theksuar se e paditura përkundër obligimeve, përkatësisht fitimit të të drejtave të cilat rrjedhin nga Kontrata kolektive e Arsimit dt.18.04.2017 dhe 22.01.2021 kontratës individuale nuk ka bërë kompensimin e shujtave për ditët e pranisë në punë për 419 ditë, të cilat janë në shumë totale prej 838.00 eurove, kjo sipas Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë. Andaj i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj padinë dhe kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar dhe ta detyroj të paditurën që të bëjë kompensimin e shumës së precizuar në emër të kërkesave të lartcekura.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, me anë të përgjigjes në padi, me dt.31.10.2024 i ka pohuar faktet vendimtare duke theksuar se e konteston kërkesëpadinë e paditësit, për pagesën e shpenzimeve për ushqim gjatë punës. Ka shtuar se paditësi fillimisht është dashur që këtë çështje ta inicioi në procedurë administrative, duke ju drejtuar të paditurës. Ka theksuar se padia nuk ka bazë juridike, ngase me dispozitat kalimtare të kontratës kolektive në fuqi nga dt.18.04.2017 dhe 22.01.2021, në nenin 46 të saj është paraparë se: MASHT dhe SBASHK, angazhohen bashkërisht për t'i informuar dhe ndihmuar Komunitat që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe kostos financiare për zbatimin e dispozitave të nenit 35 dhe paragrafët e këtij neni, andaj e paditura nuk ka buxhet për kryerjen e obligimeve ndaj punëtorëve. Ka shtuar se kjo kontrate kolektive sipas nenit 90.5 të LP –së vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara në kontratën kolektive.

Ka shtuar se paditëses duhet ti hiqen 28 dite pune për shkak të shkëputjes së kontratës kolektive më dt. 21.11.2022.

Andaj, i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit për kompensimin për ushqim gjatë orarit të punës ta refuzoj si të pa bazuar.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi, i ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 152 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se: *“po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundërt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim”*, lidhur me nenet 143 dhe 147 të të njëjtit ligj, nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij, dhe ka gjetur se në këtë çështje juridike kontestuese plotësohen kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit pa shqyrtim kryesor.

Gjykata, duke pasur parasysh faktin se i padituri i ka pohuar faktet vendimtare, përkundërt kontestimit të kërkesëpadisë, ka vlerësuar se në këtë çështje juridike kontestuese nuk është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit kryesor dhe administrimi i provave për faktet e pohuara.

Nga shkresat e lëndës vërtetohet se nuk është kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, po ashtu nuk është kontestuese se e paditura nuk i ka paguar paditësit pagesën e ushqimit ditorë për ditët e pranisë në punë pasi që një gjë e tillë nuk kontestohet nga palët, kjo vërtetohet dhe me provat materiale në shkresat e lëndës.

Andaj, gjykata, konform nenit 152 dhe 398 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pjesërisht e bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke iu referuar dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e dt.18.04.2017 dhe 22.01.2021, konkretisht nenin 35 par.7 ku është përcaktuar se: *“Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a*

kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim.”, por këtë nuk e ka bërë e paditura edhe pse ka qenë e obliguar ta bëjë këtë.

Po ashtu kjo është e rregulluar me Ligjin nr.03/L-212 e Punës, sipas nenit 90 par.4 të tij ku thuhet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se 3 (tri) vjet.*”, siç është dhe me këtë Kontratë e cila gjen zbatim për rastin e paditësit.

Gjykata lidhur me lartësinë e kërkesëpadisë (duke iu llogaritur shujta nga 2 euro për një ditë të pranisë në punë) vendosi duke u bazuar në Vërtetimin e lëshuar nga SHFMU ”I. R.“ ne P., me nr.207/2022, te dt.22.03.2022, Vërtetimin e lëshuar nga SHFMU ”I. R.“ ne P., me nr.368/2023, te dt.11.09.2023 mbi ditët e pranisë në punë si dhe Kontratë Pune me nr. Prot.05 nr.1143/2 e datës 01.09.2021 lëshuar ne emër të paditëses si provë, e që në këtë rast kemi të bëjmë me një dokument publik i cili ka fuqi të plotë provuese, e që në anën tjetër e paditura nuk i ka rrëzuar me prova materiale fuqinë provuese të këtij dokumenti, kjo dhe bazuar në dispozitën e lart cituar të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, konkretisht nenit 35 par.7 të saj.

Gjykata i konsideron si të pa pranueshme dhe të pa bazuara pretendimet dhe kundërshtimet e paditurës se ajo nuk ka asnjë obligim ndaj paditësit me arsyetim se nuk ka buxhet për të bërë këto pagesa të shujtave të ushqimit, për çka edhe i ka propozuar gjykatës që padia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pa bazuar. Po ashtu gjykata nuk i mori parasysh edhe pretendimet e te paditurës ku ka theksuar se paditëses duhet ti hiqen 28 dite pune për shkak te shkëputjes se Kontrates Kolektive me dt. 21.11.2022, ngase gjykata vlerësoi se paditësja kompensimin e shujtave e ka kërkuar brenda periudhës dhe në kohën kur ka qenë ne fuqi kontrata kolektive pra deri me dt. 21.11.2022.

Kamatë vonesa është vendosur në kuptim të dispozitave të nenit 382.2 të Ligji Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e palëve dhe provat tjera të ofruara, por vlerësoi se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të çështjes kontestimore si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore komform nenit 449, 450,452 dhe 453.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, Udhëzimit Administrativ të KGJK-së nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore si dhe Rregullores për Tarifat e Avokatëve e Odës së Avokatëve të Kosovës (2017). Lartësia e këtyre shpenzimeve të aprovuara u referohet për përpilimin e padisë shuma prej 104 euro, taksave gjyqësore të paguara për padi në shumë prej 20.00 eurove, për precizimin e padisë shuma prej 50.00 Euro, apo gjithsejtë shuma e shpenzimeve të aprovuara prej 174.00 euro, duke marrë për bazë vetëm ato shpenzime të cilat kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjykatë.

Andaj gjykata ia aprovoj shpenzimet e procedurës kontestimore, duke marrë për bazë vetëm ato shpenzime të cilat kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjykatë.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e cekura më lartë.

**Gjykata Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë,
Departamenti i Përgjithshëm C.nr.1419/23, me dt.02.11.2024**

Numri i lëndës: 2023:209874
Datë: 04.11.2024
Numri i dokumentit: 06394785

Gjyqtari :
Binak Duqi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimi pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.